

POLITIKA E PRIVATËSISË NË SHOQËRINË ALBSIG JETË sh.a.

ALBSIG Jetë sh.a. ALBSIG Jetë ose Shoqëria respekton privatësinë e klientëve, aplikantëve, personave të siguruar, përfituesve, punonjësve, partnerëve të biznesit dhe çdo subjekti tjetër të të dhënave personale me të cilin ndërvepron. Shoqëria angazhohet të përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 Për brojtjen e të dhënave Personale legjislationin sektorial dhe rregullator të zbatueshëm, si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

y Njoftim për Privatësinë shpjegon mënyrën se si ALBSIG Jetë mbledh, përdor, përpunon, ruan dhe mbron të dhënat personale, si dhe të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Kush është kontrolluesi i të dhënave?

ALBSIG Jetë sh.a., me seli në “Downtown One”, Bulevardi “Bajram Curri”, HQ, Kati 16, Tiranë, vepron në cilësinë e **Kontrolluesit të të Dhënave Personale** për përpunimet që kryen në kuadër të veprimtarisë së saj të sigurimit të jetës, në përputhje me legjislationin në fuqi.

Për çdo pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale ose për ushtrimin e të drejtave tuaja, mund të na kontaktoni në:

E-mail: info@albsig-jete.al

Nëpunësi për Mbrojtjen e të Dhënave (DPO): dpo@albsig-jete.al

Çfarë të dhënash përpunojmë?

Në varësi të produktit të sigurimit, marrëdhënies me Shoqërinë dhe qëllimit të përpunimit, ALBSIG Jetë mund të përpunojë kategoritë e mëposhtme të të dhënave personale:

- të dhëna identifikuese dhe të dhëna të kontaktit, si emër, mbiemër, numër identifikimi, datëlindje, adresë, numër telefoni dhe adresë e maili;
- të dhëna që lidhen me aplikimin dhe kontratën e sigurimit, përfshirë të dhënat e policës, periudhën e sigurimit, shumën e siguruar dhe të dhëna të tjera të nevojshme për administrimin e kontratës;
- të dhëna financiare dhe të pagesave, përfshirë të dhëna të nevojshme për administrimin e primeve, pagesave dhe detyrimeve të lidhura me kontratën;
- të dhëna mbi të siguruarin dhe përfituesit, sipas marrëdhënies dhe produktit të sigurimit;
- të dhëna të lidhura me vlerësimin e riskut dhe marrjen në sigurim, në masën e nevojshme për vlerësimin dhe administrimin e riskut të sigurimit;
- të dhëna të lidhura me kërkesat për përfitime dhe dëmshpërblime, përfshirë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për shqyrtimin dhe trajtimin e kërkesës;
- të dhëna që lidhen me përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullatore, kur përpunimi i tyre kërkohet nga legjislationi në fuqi;
- të dhëna të nevojshme për identifikimin dhe verifikimin e subjektit dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullatore të Shoqërisë, sipas rastit;
- kategori të veçanta të të dhënave personale, përfshirë të dhënat shëndetësore, kur përpunimi i tyre është i nevojshëm për vlerësimin e riskut, marrjen në sigurim, administrimin e kontratës së sigurimit ose trajtimin dhe vlerësimin e kërkesave për përfitime dhe dëmshpërblime, në përputhje me legjislationin në fuqi.

Burimi i të dhënave personale

ALBSIG Jetë sh.a. mund të mbledhë të dhëna personale nga burime të ndryshme, në varësi të produktit ose shërbimit të ofruar, marrëdhënies me subjektin e të dhënave dhe qëllimit të përpunimit.

1. Të dhëna të mbledhura drejtpërdrejt nga ju

Në shumicën e rasteve, ALBSIG Jetë sh.a. mbledh të dhënat personale drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave, përfshirë nëpërmjet:

- aplikimeve për sigurim;
- formularëve dhe dokumentacionit të paraqitur nga ju;
- komunikimeve me Shoqërinë;
- aplikimeve ose kërkesave të paraqitura nëpërmjet kanaleve fizike ose elektronike;
- formularëve të kontaktit ose komunikimeve nëpërmjet faqes së internetit;
- proceseve të lidhura me lidhjen dhe administrimin e kontratës së sigurimit.

2. Të dhëna të mbledhura në mënyrë automatike

Gjatë përdorimit të faqes sonë të internetit ose kanaleve të tjera elektronike, mund të mblidhen automatikisht të dhëna teknike dhe informacione lidhur me përdorimin e tyre.

ëto të dhëna mund të përfshijnë, sipas rastit, informacion mbi pajisjen, shfletuesin, adresën IP, informacion teknik dhe të dhëna mbi mënyrën e përdorimit të faqes. Për më shumë informacion mbi përdorimin e cookies dhe teknologjive të ngjashme, ju lutemi referojuni **Politikës sonë të Cookies**.

3. Të dhëna të mbledhura nga palë të treta

Në varësi të produktit, shërbimit dhe qëllimit të përpunimit, ALBSIG Jetë sh.a. mund të marrë të dhëna personale edhe nga palë të treta ose burime të tjera të ligjshme, përfshirë:

- bankat, në kuadër të marrëdhënieve dhe produkteve të sigurimit;
- agjentët, brokerat dhe ndërmjetësit e sigurimit;
- përfituesit ose persona të tjerë të autorizuar, kur kjo është e nevojshme për administrimin e marrëdhënies së sigurimit ose trajtimin e kërkesave për përfitime dhe dëmshpërblime;
- institucionet shëndetësore dhe profesionistët e shëndetit, kur kjo është e nevojshme dhe e lejuar për qëllimet përkatëse të përpunimit;
- autoritetet publike dhe mbikëqyrëse, kur kjo parashikohet nga legjislacioni në fuqi;
- regjistra ose burime publike, kur marrja e të dhënave nga këto burime lejohet nga legjislacioni në fuqi;
- burime të tjera të ligjshme, kur mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale janë të lejuara dhe të nevojshme për qëllimin përkatës.

Për çfarë qëllimesh i përdorim të dhënat?

Të dhënat personale përpunohen, sipas rastit dhe në varësi të produktit, shërbimit dhe marrëdhënies me ALBSIG Jetë, për:

- shqyrtimin dhe administrimin e aplikimeve për sigurim;
- vlerësimin e riskut dhe marrjen në sigurim under riting ;
- lidhjen, administrimin dhe përmbushjen e kontratave të sigurimit;
- administrimin e kontratave gjatë periudhës së vlefshmërisë së tyre;
- trajtimin, verifikimin dhe administrimin e kërkesave për përfitime dhe dëmshpërblime;

- administrimin e marrëdhënieve me bankat, agjentët, brokerat dhe partnerët e biznesit;
- komunikimin me klientët, personat e siguruar, përfituesit dhe personat e autorizuar;
- përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullatore të Shoqërisë;
- identifikimin dhe verifikimin e subjekteve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore, sipas rastit;
- administrimin financiar, kontabilitetin, faturimin dhe pagesat;
- mena himin dhe sigurinë e sistemeve të informacionit;
- mbrojtjen dhe ushtrimin e të drejtave dhe interesave legjitime të Shoqërisë;
- marketingun dhe komunikimet tregtare, kur ekziston baza ligjore përkatëse.

Shoqëria përpunon vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme, të përshtatshme dhe proporcionale për realizimin e qëllimeve për të cilat ato mblidhen dhe përpunohen.

Në varësi të qëllimit dhe rrethanave të përpunimit, ALBSIG Jetë përpunon të dhënat personale mbi bazën e një ose më shumë bazave ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, duke përfshirë, sipas rastit, përmbushjen e një kontrate ose marrjen e masave para lidhjes së saj, përmbushjen e një detyrimi ligjor, mbrojtjen e interesave legjitime të Shoqërisë, si dhe pëlqimin e subjektit të të dhënave kur ai kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Për kategoritë e veçanta të të dhënave personale, përfshirë të dhënat shëndetësore, ALBSIG Jetë siguron që përpunimi të kryhet vetëm kur ekziston baza dhe kushti i posaçëm ligjor i kërkuar për këtë kategori të dhënash.

Mbi çfarë baze ligjore i përpunojmë të dhënat?

ALBSIG Jetë përpunon të dhënat personale vetëm kur ekziston një bazë ligjore për përpunimin, në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin tjetër të zbatueshëm.

Në varësi të qëllimit dhe rrethanave të përpunimit, baza ligjore mund të jetë:

- marrja e masave me kërkesë të subjektit të të dhënave përpara lidhjes së një kontrate ose përmbushja e një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave është palë;
- përmbushja e një detyrimi ligjor që i ngarkohet Shoqërisë;
- mbrojtja e interesave legjitime të Shoqërisë ose të një pale të tretë, për aq kohë sa këto interesa nuk mbizotërohen nga interesat ose të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave;
- pëlqimi i subjektit të të dhënave, në rastet kur përpunimi bazohet në pëlqim dhe ky kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ALBSIG Jetë mund të përpunojë të dhëna personale edhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni specifik i zbatueshëm, përfshirë:

- **Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”,** i ndryshuar;
- **Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”,** i ndryshuar;
- **Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”,** i ndryshuar;
- **legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;**
- si dhe çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor që është i zbatueshëm për veprimtarinë e Shoqërisë dhe kërkon ose lejon përpunimin e të dhënave personale.

ur përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale, përfshirë të dhënat shëndetësore, ALBSIG Jetë siguron që përpunimi të kryhet vetëm kur plotësohen kushtet e posaçme të përcaktuara nga Ligji nr. 124/2024 dhe legjislacioni sektorial i zbatueshëm. Të dhënat shëndetësore janë kategori e veçantë e të dhënave personale dhe përpunimi i tyre i nënshtrohet një mbrojtjeje të posaçme.

Me kë mund të ndahen të dhënat?

ur është e nevojshme për qëllimet e përpunimit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, ALBSIG Jetë mund t'u komunikojë të dhënat personale:

- autoriteteve publike dhe autoriteteve mbikëqyrëse;
- bankave;
- agjentëve, brokerave dhe ndërmjetësve të sigurimit;
- shoqërive të risigurimit;
- institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve të shëndetit, kur është e nevojshme;
- ofruesve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
- ofruesve të shërbimeve profesionale;
- përpunuesve që veprojnë në emër dhe për llogari të ALBSIG Jetë;
- palëve të tjera, kur komunikimi i të dhënave kërkohet ose lejohet nga legjislacioni në fuqi.

ALBSIG Jetë kufizon komunikimin e të dhënave personale në të dhënat që janë të nevojshme për qëllimin përkatës dhe merr masa të përshtatshme për të garantuar konfidencialitetin, sigurinë dhe përpunimin e ligjshëm të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, sipas rastit, marrëveshjet dhe detyrimet kontraktore të zbatueshme.

Sa kohë ruhen të dhënat?

Të dhënat personale ruhen vetëm për periudhën e nevojshme për realizimin e qëllimeve për të cilat janë mbledhur dhe përpunuar, duke marrë parasysh afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, detyrimet ligjore dhe rregullatore, detyrimet kontraktore, si dhe nevojën për ushtrimin ose mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të Shoqërisë.

Afati i ruajtjes mund të ndryshojë në varësi të llojit të të dhënave, qëllimit të përpunimit, natyrës së marrëdhënies me subjektin e të dhënave dhe kërkesave ligjore ose rregullatore të zbatueshme.

Pas përfundimit të afatit përkatës të ruajtjes, të dhënat personale fshihen, asgjësohen, anonimizohen ose arkivohen, sipas rastit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e brendshme të Shoqërisë.

Cilat janë të drejtat tuaja?

Në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 Për mbrojtjen e të dhënave personale, ju gëzoni, sipas kushteve dhe kufizimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të drejtën:

- të informoheni mbi përpunimin e të dhënave tuaja personale;
- të kërkonti akses në të dhënat tuaja personale dhe informacionin lidhur me përpunimin e tyre;
- të kërkonti korrigjimin ose plotësimin e të dhënave personale të pasakta ose të paplota;
- të kërkonti fshirjen e të dhënave personale, në rastet e parashikuara nga ligji;
- të kërkonti kufizimin e përpunimit, në rastet e parashikuara nga ligji;
- të kundërshtoni përpunimin e të dhënave personale, në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara nga legjislacioni;
- të tërhiqni pëlqimin, në rastet kur përpunimi bazohet në pëlqimin tuaj, pa cenuar ligjshmërinë e përpunimit të kryer përpara tërheqjes së pëlqimit;
- të ushtroni të drejtën e portabilitetit të të dhënave, kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji;

- të mos jeni subjekt i një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin automatik të të dhënave, përfshirë profilizimin, kur një vendim i tillë sjell pasoja ligjore ose pasoja të ngjashme të rëndësishme, në përputhje me kushtet dhe përjashtimet e parashikuara nga ligji;
- të paraqisni ankesë pranë omisionerit për të rejtën e Informimit dhe brojtjen e të dhënave Personale, nëse konsideroni se përpunimi i të dhënave tuaja personale është kryer në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Si mund t'i ushtroni të drejtat tuaja?

Për të ushtruar të drejtat tuaja lidhur me përpunimin e të dhënave personale, mund të paraqisni një kërkesë me shkrim në adresën elektronike dpo albsig jete.al ose në adresën e selisë së ALBSIG Jete sh.a.

ërkesa duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për identifikimin e kërkuarit dhe për shqyrtimin e kërkesës.

ALBSIG Jete do ta shqyrtojë kërkesën dhe do t'ju përgjigjet brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

ur është e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe parandalimin e aksesit të paautorizuar, ALBSIG Jete mund të kërkojë informacion shtesë për verifikimin e identitetit të kërkuarit.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

ALBSIG Jete, në parim, përpunon dhe ruan të dhënat personale brenda epublikës së Shqipërisë.

Në rastet kur, për përmbushjen e qëllimeve të përpunimit ose për përmbushjen e detyrimeve kontraktore apo ligjore, lind nevoja për transferimin e të dhënave personale jashtë epublikës së Shqipërisë, ALBSIG Jete siguron që një transferim i tillë të kryhet vetëm në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 124/2024 Për brojtjen e të dhënave Personale dhe duke zbatuar garancitë e përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave.

ur transferimi kryhet drejt një shteti ose organizate ndërkombëtare që nuk garanton një nivel mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, ALBSIG Jete zbaton garancitë e përshtatshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Siguria e të dhënave

ALBSIG Jete zbaton masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke marrë parasysh natyrën, fushën e veprimtarisë, qëllimet e përpunimit dhe rreziqet e mundshme për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.

e qëllim mbrojtjen e të dhënave personale, ALBSIG Jete merr masa për garantimin e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe sigurisë së të dhënave personale, si dhe për parandalimin e aksesit, përdorimit, ndryshimit, humbjes, shkatërrimit ose zbulimit të paautorizuar të tyre.

Në varësi të natyrës së përpunimit dhe nivelit të rrezikut, masat e zbatuara mund të përfshijnë, ndër të tjera:

- kufizimin e aksesit në të dhënat personale vetëm për personat e autorizuar dhe në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre;
- masa për verifikimin e identitetit të përdoruesve dhe kontrollin e aksesit në sistemet dhe të dhënat personale;
- përdorimin e fjalëkalimeve personale dhe masave të tjera të sigurisë për mbrojtjen e sistemeve dhe pajisjeve;
- masa për mbrojtjen e pajisjeve, sistemeve dhe programeve kompjuterike nga aksesi ose përdorimi i paautorizuar;

- masa për mbrojtjen fizike të ambienteve, dokumentacionit dhe pajisjeve ku ruhen ose përpunohen të dhëna personale;
- masa për kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar në ambientet dhe mjetet e përpunimit të të dhënave;
- zbatimin e masave për ruajtjen, rikuperimin dhe rivendosjen e disponueshmërisë së të dhënave dhe sistemeve, në rast të incidenteve fizike ose teknike;
- testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin periodik të efektivitetit të masave teknike dhe organizative të sigurisë;
- zbatimin e detyrimeve të konfidencialitetit nga personat që përpunojnë të dhëna personale;
- dokumentimin dhe ndjekjen e proceseve që lidhen me sigurinë dhe përpunimin e të dhënave personale;
- organizimin e veprimtarive informuese dhe trajnuese për punonjësit lidhur me mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

ALBSIG Jetë rishikon dhe përditëson masat e saj të sigurisë sipas nevojës, duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, ndryshimet në proceset e përpunimit dhe nivelin e rrezikut.

Në rast të një cenimi të të dhënave personale, ALBSIG Jetë ndërmerr masat e nevojshme për trajtimin dhe vlerësimin e incidentit dhe vepron në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 124/2024 dhe legjislacionit në fuqi.

Cookies

Për më shumë informacion mbi përdorimin e cookies dhe teknologjive të ngjashme në faqen tonë të internetit, ju lutemi referojuni Politikës së Cookies.

Përditësimi i Politikës

ALBSIG Jetë mund ta përditësojë këtë Politikë të Privatësisë në çdo kohë, në përputhje me ndryshimet ligjore ose operacionale. Versioni i përditësuar do të publikohet në këtë faqe.

Versioni: 1.1

Përditësimi i fundit: 03.09.2026

© ALBSIG Jetë sh.a.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.